

V E N D I M
Nr. 491, datë 14.8.2001

**PËR PJESËMARRJEN ME KONTRATË MENAXHIMI TË SEKTORIT PRIVAT NË
SHOQËRINË ANONIME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE TË BASHKISË SË KAVAJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr. 8103, datë 28.3.1996 “Për privatizimin e ndërmarrjeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura” dhe të nenit 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies me koncesion të shoqërisë anonime të ujësjellës-kanalizimeve të Bashkisë së Kavajës, sipas formës “Kontratë e administrimit (menaxhimit)”.

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike të jenë organi i autorizuar shtetëror, për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit.

Procedura për përzgjedhjen e kontratës të jetë “Propozim i kërkuar”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike, që, në bashkëpunim me këshilluesin ndërkombëtar, të përgatisin kontratën e menaxhimit dhe të dokumenteve e të materialeve të nevojshme për përzgjedhjen e operatorit privat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta